

**THE DEVELOPMENT OF EDUCATION PROCESS OF ALBANIANS IN
THE PEOPLE'S REPUBLIC OF MACEDONIA IN THE 50S OF XX
CENTURY**

**ZHVILLIMI I ARSIMIT TE SHQIPTARËT E RP TË MAQEDONISË NË
VITET E '50-TA TË SHEK.XX**

Sokol MEMETI¹

¹ Department of History, Faculty of Philosophy, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: sokol.memeti@unite.edu.mk

Arsimi gjatë viteve të '50-ta te shqiptarët e RP të Maqedonisë u përball me represione të ndryshme, siç ishin: arrestimi dhe diferencimi i një numri të madh mësimdhënësish, (si gjatë këtyre viteve, por edhe më herët gjatë viteve të '40-ta), procesi i shpërnguljes së një numri të madh nxënësish dhe mësuesish (që zvogëloi dukshëm numrin e nxënësve), mungesa e kuadrit cilësor arsimor, pajisja e papërshtatshme me libra shkollorë, si dhe objektet e pamjaftueshme shkollore.

Që të ndërtonte një sistem arsimor sipas dëshirës së tij te shqiptarët, pushteti maqedonas në Plenumin e Tretë të KQ të PKM-së, i cili zhvilloi punimet më 5 janar 1950, pati diskutuar përvojën e huazuar për punën me shqiptarët e Kosovës dhe zbatimin e saj në RP të Maqedonisë si dhe si detyrë kryesore ishte vendosur thellimi edhe më tej i punës ideore-politike dhe kulturore-arsimore te shqiptarët e RP të Maqedonisë. Falë vendimeve që ishin marrë në Plenum, ishte zgjeruar puna për zhvillimin kulturor-arsimor të shqiptarëve, sidomos masa më të ashpra ishin marrë për zhdukjen e analfabetizmit te gratë shqiptare.²³⁷

PKM-ja dhe PKS-ja ishin pajtuar që për luftë më të ashpër kundër analfabetizmit te shqiptarët e RP të Maqedonisë, të dërgoheshin në vitin 1950, me urdhër të Komitetit Qarkor të PKS-së, dy pedagogë me përvojë; për gjimnazin shqiptar dhe për shkollën për mësues në Tetovë.²³⁸ Falë këtyre vendimeve, deri në vitin 1952, nga gjithsej 77.267 analfabetë shqiptarë të moshës 10 deri në 45 vjeçare, u aftësuan gjithsej 56.763 vetë ndërsa, për t'u aftësuar ngelën 20.504, shumica e tyre gra. Në rrethin e Strugës kishin ngelur 101 analfabetë shqiptarë deri në moshën 45 vjeçare. Në Kumanovë, në vitin 1952, ishin përfshirë 2.047 gra kurse në Gostivar po këtë vit kursin analfabetik e kishin vijuar 184 burra dhe 1.555 gra, gjithsej 1.739 vetë.²³⁹

²³⁷ Marijana Stamova, *Faktori shqiptar në Republikën Socialiste të Maqedonisë (1945-1981)*, Tiranë, 2014, f. 63.

²³⁸ *Po aty*.

²³⁹ Qerim Lita, *NAÇERTANIA - K. Cërvenkovski dhe identiteti shqiptar në Maqedoni (1945-1954)*, Shkup, 2007, f. 119.

Mirëpo, pavarësisht luftës kundër analfabetizmit të popullsisë shqiptare, përqindja e analfabetëve përsëri mbeti e lartë. Sipas regjistrimit të vitit 1953, në komunën e Likovës kishte 6.600 analfabetë, prej tyre 2.434 burra, mbi moshën 10 vjeçare ose 45% nga numri i përgjithshëm i tyre, dhe 4.166 gra ose 75% nga numri i përgjithshëm i tyre.²⁴⁰ Një vendim tjetër i PKM-së ishte hapja e një shkolle normale shqiptare në Tetovë. Komisioni për hapjen e Normales Shqiptare në Tetovë, në mbledhjen këshilluese të tij, të mbajtur në këtë qytet më 26 maj 1950, pas vizitës së objektit të paraparë për funksionimin e kësaj normaleje mori vendimin që shkolla e re të formuar të mbajë emrin “Naim Frashëri”, i cili emër më vonë do të përcaktohej nga ministria. Kështu që emri i shkollës, nga atje u caktua të jetë “Liria”.²⁴¹

Po ashtu, u vendos që të kishte 130 nxënës, të sistemuar në konvikt, me gjasë që numri i tyre të shkonte deri në 150, duke përfshirë këtu edhe nxënës që nuk do të banonin në objektin e shkollës. Këta nxënës do të ndaheshin në 4 paralele. Ministria e Arsimit emëroi drejtorin dhe ligjëruesit, kurse Kuvendi Popullor i Qytetit emëroi një drejtues të internatit, 1 nikoqir, 1 ekonomist, 1 sekretar të përbashkët për shkollën dhe internatin, 2 gjellëbërës dhe 2 ndihmës të tyre, 5 pastrues dhe 2 rrobalarëse.²⁴²

Drejtori i Gjimnazit të Tetovës për t’i dhënë ndihmë normales, premtoi angazhimin me honorar të tre profesorëve nga shkolla që ai drejtonte, 1 për Histori, 1 për Gjeografi dhe Biologji dhe 1 për Kimi dhe Fizikë. Kuvendi Popullor i Qytetit siguroi edhe 4 banesa për arsimtarët, të cilët udhëtonin nga qytetet tjera.²⁴³ Në këtë mbledhje po ashtu, u vendos që për funksionimin e shkollës normale, të shfrytëzohej objekti i shkollës fillore. U vendos edhe që të ndaheshin mjete për Kuvendin Popullor të Qytetit për përfundimin e punëve të tjera, deri në sisteminin e të gjitha gjërave të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit arsimor. U meremetua objekti aktual, u ndërtua edhe një objekt tjetër pranë më të vjetrit dhe u sigurua inventari i nevojshëm për klasat dhe internatin.²⁴⁴

Mirëpo, në fund të vitit shkollor 1951-1952, me vendim të Komitetit Qendror të PKM-së, kjo normal u mbyll. Pra funksionoi vetëm një vit. Mbyllja erdhi pas propozimit të ekipit të Ministrisë së Arsimit, i cili ishte zgjedhur në janar të vitit 1952, nga ana e Byrosë Politike të KQ të PKM-së, me detyrë që të bëjë vizitë pune nëpër shkolla.²⁴⁵ Një tjetër goditje e madhe që iu dha arsimit shqip ishte hapja e shkollave turke në vendbanimet shqiptare. Puna për hapjen këtyre shkollave filloi qysh në qershor të vitit 1951, kur një ekip i KQ të LKJ-së zhvilloi një vizitë zyrtare në RP të Maqedonisë, ku zhvilloi disa takime me komitetet e vendit të PKM-së, për të studiuar mundësinë e hapjes së tyre. Nga vizita e realizuar, ky ekip i dërgoi një raport KQ të PKJ-së, në të cilën theksonte se: elementi shqiptaromadhi ishte forcuar shumë dhe se gjasat për hapjen e shkollave turke ishin shumë të vogla, për shkak edhe të armiqësive mes shqiptarëve dhe turqve.²⁴⁶

Falë këtyre zhvillimeve, në një mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PKM-së, të mbajtur më 9 prill 1952 u vendos që të hapeshin më shumë shkolla turke, të ndërtoheshin objekte të reja shkollore dhe të mbylleshin shkollat e deriatëhershme në mektebe, xhami dhe objekte private, shkolla normale e Tetovës të transferohet në Shkup, në kuadër të normales që tashmë funksiononte dhe në të të hapen edhe paralele në gjuhën turke. Të sillen mësues nga Kosova, të sillen edhe materiale shkollore nga atje, të pastrohen shkollat nga mësuesit e përgatitur dobët dhe mësuesit nga Shqipëria, në planprogramin e shkollave në gjuhën shqipe të rritej numri i

²⁴⁰ Qerim Lita, *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974-Përmbledhje dokumentesh - Procesi i shpërnguljes*, vëllimi II, Shkup, 2018, f. 246.

²⁴¹ Qerim Lita, *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974-Përmbledhje dokumentesh - Arsimi, Kultura, Religjioni*, vëllimi VI, Shkup, 2018, f. 114.

²⁴² *Po aty*, f. 115.

²⁴³ *Po aty*, f. 116.

²⁴⁴ *Po aty*, f. 117.

²⁴⁵ Qerim Lita, *NAÇERTANIA...*, f.156.

²⁴⁶ Qerim Lita, *Territoret lindore shqiptare 1912-1960 (Punime studimore)*, Shkup, 2016, f. 173-174.

orëve për gjuhën maqedonase, të futej mësimi për Luftën Nacional-Çlirimtare dhe historinë e përgjithshme të popujve të Jugosllavisë. Për vajzat të futej mësimi për punë shtëpiake, për higjienë etj., kurse, për djemtë mësimi për bujqësi dhe blegtori. Të organizohen programe për ngritjen ideologjike të mësuesve, të hapen universitete popullore për mësimin e shkrim-leximit, të merren masa që në vazhdim të regjistrohen nxënës shqiptarë në shkollat e mesme teknike, bujqësore dhe mjekësore, të merren masa për zhvillimin e shoqërive kulturore-artistike dhe zhvillimin e artit dhe kulturës në përgjithësi, të përhapej përdorimi sa më i gjerë i gazetave, etj.²⁴⁷

Në këtë mbledhje u propozuan edhe disa masa të tjera si: vizita më e shpeshtë e inspeksioneve arsimore nëpër shkollat në gjuhën shqipe, t'i kushtohej një rëndësi më e madhe mësimi të gjuhës maqedonase nëpër shkollat pedagogjike nga ana e mësuesve shqiptarë dhe ajo të futej si provim në testet shtetërore, të rritej kriteri i notimit të mësuesve si dhe të rritej kriteri në testet shtetërore për mësuesit, etj.²⁴⁸ Në fillim të vitit 1952, KQ i PKM-së votoi formimin e një komisioni, në lidhje me formimin e shkollave turke. Komisionin e udhëhiqte Kërste Cërvenkovski dhe ishte në përbërje të Mito Temenugov, Reiz Shaqiri, Boge Kuzmanovski, Tome Buklevski-Maçuli, Gjore Gjorevski dhe Allojz Pipan. Nga 17 janari deri në 3 shkurt 1952, komisioni vizitoi rrethet e Tetovës, Gostivarit, Dibrës, Strugës, Kërçovës, Kumanovës, Gjorçe Petrovit dhe Resnjës.

Ky komisioni organizoi takime me komitetet e rretheve, organizatat bazë, organizatat masive, shoqëritë kulturore-artistike etj. Në bazë të raportit të përpiluar nga ky komision, u mbajtë një mbledhje e Byrosë Politike. Në të u aprovua një analizë me rreth 40 faqe e ndarë në katër nëntituj kryesorë. Në analizë flitej për çështje të ndryshme, ndërkaq në lidhje me çështjen e arsimit, kërkohej hapja e shkollave turke, mbyllja e Normales në Tetovë dhe hapja e paraleleve shqipe dhe turke në Normalen e Shkupit.²⁴⁹

Në vitin shkollor 1951-1952 në Pollog u hapën 6 shkolla me mësim në gjuhën turke, edhe atë në Tetovë, Tearcë dhe në Gostivar, Vrapçisht, Banjicë e Poshtme e Banjicë e Epërme, ndonëse numri i përgjithshëm i turqve në këtë rajon sipas regjistrimit të vitit 1948 ishte vetëm 737. Shkolla të tilla atë vit shkollor u hapën edhe në Dibër, Kërçovë, Manastir, Strugë, Resnjë, Krushevë dhe Prilep. Kështu, edhe pse numri i shkollave në gjuhën turke, u rrit nga 104 në 144, numri i nxënësve që e ndiqnin mësimin në këtë gjuhë, nuk dallonte shumë nga viti paraprak, nga 12.493 në 13.237, kurse numri i mësimeve të turqve u rrit nga 237 në 293 arsimtarë.²⁵⁰

Hapja e shkollave turke shkaktoi reagimin e mësimeve shqiptarë. Komisioni për Arsim dhe Kulturë, nëpërmjet një analize njoftonte KQ të PKM-së për rezistencën që bënin arsimtarët shqiptarë, sidomos në rrethet e Tetovës dhe Gostivarit.²⁵¹ Në anën tjetër, Dhoma e Politikës së Jashtme pranë KQ të PKM-së, në një analizë që i kushtohej veprimtarisë së inteligjencës shqiptare, komiteteve shqiptare në Perëndim dhe shërbimit informativ shqiptar, ndër të tjera fliste për kundërshtimin që intelijenca shqiptare i kishte bërë hapjes së shkollave turke. Ndër më të zëshmit ishin Mehmetriza Gega në Tetovë dhe Murtezan Bajraktari në Gostivar.²⁵² Lufta kundër analfabetizmit dhe ngritja e vetëdijes për shkollim te popullsia shqiptare, filloi të reflektohet gjatë viteve të '50-ta.

²⁴⁷ Славко Милосавлевски, Мирче Томовски, *Албанците во Република Македонија 1945-1995 (Легислатива, Политичка документација, Статистика)*, Скопје, 1997, f. 50-53.

²⁴⁸ *Po aty*, f. 53-55.

²⁴⁹ Qerim Lita, *Territoret lindore shqiptare...*, f. 174-175.

²⁵⁰ Qerim Lita, *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974-Përmbledhje dokumentesh - Qëndresa antikomuniste*, vëllimi I, Shkup, 2018, f. 31, 485; I njëjti, *Territoret lindore shqiptare...*, f. 175-176.

²⁵¹ Qerim Lita, *Territoret lindore shqiptare...*, f. 176-177.

²⁵² *Po aty*, f. 177-178.

Kështu, në vitin shkollor 1949-1950 në territorin e RP të Maqedonisë, punonin 238 shkolla me mësim në gjuhën shqipe, me 28.432 nxënës,²⁵³ kurse, sipas disa të dhënave të tjera kishte 224 shkolla me gjithsej 26.349 nxënës²⁵⁴. Përveç kësaj funksiononin edhe dy gjimnaze të plota në Tetovë dhe Gostivar, 6 shtatëvjeçare, 16 paralele në gjimnaze jo të plota dhe 2 paralele në normalen e Shkupit.²⁵⁵ Për këtë vit shkollor 1949-1950 përgatitja profesionale e mësimdhënësve shqiptarë ishte kështu; me shkollë të mësuesisë 18, me kurs I të lartë 13, me kurs I të ulët 144, me kurs I dhe II të ulët 155, me kurset I, II dhe III të ulta 77. Pa kurs 61 dhe një mësuese me fakultet. Gjithsej 469 mësues, prej tyre 399 meshkuj dhe 70 femra.²⁵⁶

Kurse, në Shkollën Normale në Shkup, në të njëjtin vit shkollor, në vit të parë janë regjistruar 28 nxënës, prej të cilëve 25 kanë mbaruar, në vit të dytë 22 janë regjistruar, prej të cilëve 19 kanë mbaruar dhe në vit të tretë 18 janë regjistruar dhe të gjithë kanë mbaruar.²⁵⁷ Në vitin shkollor 1950-1951 nga 166.950 nxënës në shkollat fillore, 26.702, ishin shqiptarë, (ose 16%), të cilët mësonin në 241 shkolla. Në këto shkolla ishin angazhuar 409 mësimdhënës, 346 prej tyre në arsimin katërvjeçar. Vetëm në arsimin tetëvjeçar kishte 12 shkolla me 1.814 nxënës. Në arsimin e mesëm nga 30.301 nxënës, vetëm 1.917 ishin shqiptarë, ose 6,3% dhe kishte 62 mësimdhënës. Në të njëjtin vit, studimet i kanë ndjekur 18 studentë shqiptarë.²⁵⁸

Sipas një raporti të dërguar në Ministrinë e Arsimit, në vitin shkollor 1950-1951, në qytetin e Tetovës, prej 1.200 nxënësve shqiptarë vetëm 836 ishin përfshirë në rrjetin shkollor ndërsa, të papërfshirë kishin ngelur 364 nxënës. Në rrethin e Shkupit, prej 8.797 nxënës që ishin të obliguar t'i nënshtrohen shkollimit fillor, në vitin shkollor 1950-1951 jashtë bankave shkollore kishin mbetur 1.386 nxënës, shumica prej tyre shqiptarë.²⁵⁹ Në të njëjtin vit, numri i përgjithshëm i shkollave në gjuhën turke në tërë RP të Maqedonisë ishte 104, me 12.493 nxënës dhe 237 mësues. Në vitin e ardhshëm u hapën edhe 40 shkolla më shumë dhe numri i mësuesve u rrit në 293 arsimtarë, ndonëse rritja e numrit të nxënësve ishte vetëm në numër simbolik, me 744 nxënës më shumë, apo gjithsej 13.237 nxënës.²⁶⁰

Në Normalen e Shkupit, në po të njëjtin vit shkollor, në vit të parë ishin regjistruar 67 nxënës, prej të cilëve 63 kishin mbaruar, me dy paralele, në vit të dytë 23 janë regjistruar, dhe të gjithë kishin mbaruar kurse në vit të tretë 20 janë regjistruar, prej të cilëve 18 kishin mbaruar.²⁶¹ Në vitin shkollor 1951-1952 kishte 241 objekte shkollore, 459 mësues dhe 25.941 nxënës. Vetëm në arsimin tetëvjeçar kishte 17 shkolla me 1.318 nxënës.²⁶² Në rrethin e Gostivarit, në vitin 1952 kishte dy tetëvjeçare, në rrethin e Kërçovës një tetëvjeçare dhe një paralele shqipe pranë gjimnazit të ulët, në rrethin e Tetovës dy tetëvjeçare dhe një paralele shqipe pranë gjimnazit të plotë, në rrethin e Strugës dy tetëvjeçare, një tetëvjeçare në rrethin e Kumanovës, Manastirit dhe Shkupit.²⁶³

Në po të njëjtin vit, në rrethin e Gostivarit nuk e ndiqnin mësimin 194 nxënës, kurse 202 nuk ishin të rregullt, në rrethin e Strugës nuk e ndiqnin mësimin 38 nxënës dhe jo të rregullt ishin 44 nxënës, në rrethin e Dibrës nuk e ndiqnin mësimin 11 nxënës, kurse jo të rregullt ishin 54 nxënës dhe në rrethin e Kumanovës nuk e ndiqnin mësimin 246 nxënës.²⁶⁴

²⁵³ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi VI, f. 124-126; Zeqirja Idrizi, *Pozita e shqiptarëve në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore*, Tetovë, 2003, f. 115.

²⁵⁴ Qerim Lita, *NAÇERTANIA...*, f. 76.

²⁵⁵ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi VI, f. 124-126; Zeqirja Idrizi, *vep. cit.*, f. 115.

²⁵⁶ Qerim Lita, *NAÇERTANIA...*, f. 89.

²⁵⁷ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi VI, f. 165.

²⁵⁸ Славко Милосавлевски, Мирче Томовски, *vep. cit.*, f. 185, 337; Marijana Stamova, *vep. cit.*, f. 76; Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, f. 485, 491; I njëjti, *Problemi shqiptar...*, vëllimi II, f. 92.

²⁵⁹ Qerim Lita, *NAÇERTANIA...*, f. 90.

²⁶⁰ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, f. 32.

²⁶¹ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi VI, f. 165.

²⁶² Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi II, f. 92; I njëjti, *NAÇERTANIA...*, f. 76.

²⁶³ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi II, f. 92-93; I njëjti, *NAÇERTANIA...*, f. 118.

²⁶⁴ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi II, f. 93-94.

Nga 76 mësues të shkollave në rrethin e Gostivarit, vetëm 5 vetë ishin me shkollim të plotë normal, 4 mësues ishin me tre ose katër klasë gjimnaz, kurse të tjerët ishin me katër klasë fillore deri me 2 klasë gjimnaz dhe me një, dy, tre ose katër kurse pedagogjike, ndërsa 4 mësues ishin vetëm me katër klasë fillore. Në rrethin e Strugës me normale ishin tre mësues, një me 8 klasë, dy me 5 klasë dhe një me katër klasë gjimnaz, kurse të tjerët ishin ose me gjimnaz të ulët, gjimnaz të ulët të pambaruar, ose me ndonjë kurs të mbaruar.²⁶⁵ Në Normalen e Shkupit, në vitin shkollor 1951-1952, në vit të parë ishin regjistruar 59 nxënës, 46 kishin mbaruar me dy paralele; në vit të dytë 55 ishin regjistruar, 50 kishin mbaruar me dy paralele dhe në vitin e tretë 24 ishin regjistruar, prej të cilëve 22 kishin mbaruar.²⁶⁶

Në vitin shkollor 1952-1953 kishte 172 objekte shkollore të arsimit fillor 4 vjeçar dhe 24 objekte të arsimit fillor 8 vjeçar në gjuhën shqipe, gjithsej 196 objekte. Në shkollat fillore 4 vjeçare mësimin e ndiqnin 21.233 nxënës, me 357 arsimtarë, kurse në ato 8 vjeçare 2.153 nxënës shqiptarë, që nënkupton se në 24 shkolla, gjithsej 23.373 të tillë. Sipas disa të dhënave tjera për arsimin fillor tetëvjeçar mësimin e kanë ndjekur 25.645 nxënës. Në po të njëjtin vit shkollor, në shkollat e mesme profesionale dhe gjimnaze, mësimin në gjuhën shqipe e kishin ndjekur 234 nxënës.²⁶⁷

Në këtë vit shkollor në rrethin e Gostivarit punonin 33 shkolla fillore shqipe me 3.879 nxënës dhe vetëm dy tetëvjeçare me gjithsej 119 nxënës, ndërsa në gjimnaz, punonin katër paralele shqipe me 74 nxënës. Në rrethin e Tetovës, kishte 53 shkolla fillore me 5.553 nxënës, dy tetëvjeçare me 215 nxënës dhe përveç kësaj në qytet funksiononte shkolla fillore me 789 nxënës, ndërsa në gjimnazin e plotë punonin 14 paralele shqipe me 417 nxënës.²⁶⁸ Në vitin shkollor 1953-1954 kishte 200 objekte shkollore të arsimit fillor 4 vjeçar dhe 24 objekte të arsimit fillor 8 vjeçar në gjuhën shqipe, gjithsej 224 objekte. Në shkollat fillore 4 vjeçare mësimin e ndiqnin 19.247 nxënës, me 367 arsimtarë, kurse në ato 8 vjeçare sipas disa të dhënave 2.815, e sipas disave 3.814 nxënës shqiptarë, gjithsej 23.061 të tillë.²⁶⁹

Në po të njëjtin vit, në qarkun e Tetovës nuk ishin përfshirë në procesin arsimor 388 shkollarë të obliguar. Në vitin pasardhës 1954-1955, nuk ishin përfshirë 227 nxënës, kurse një vit pas tij, nuk ishin përfshirë 257 të tillë. Në të njëjtin qark, shkollimin katërvjeçar rregullisht e vijonin 10.077 nxënës, por prej tyre, vetëm 1.610 nxënës kishin vazhduar shkollimin në klasë të pestë.²⁷⁰ Në vitin akademik të studimeve 1953-1954, nga 4.406 studentë të regjistruar, vetëm 95 ishin shqiptarë, ose 2,1%, kurse në të njëjtin vit kishte pasur 260 studentë të diplomuar, nga ta vetëm 2 shqiptarë, ose 0,8%.²⁷¹

Në vitin shkollor 1954-1955 kishte 228 objekte shkollore të arsimit fillor katërvjeçar dhe 22 objekte të arsimit fillor tetëvjeçar në gjuhën shqipe, gjithsej 250 objekte. Në shkollat fillore katërvjeçare mësimin e ndiqnin 22.361 nxënës, me 395 arsimtarë, kurse në ato tetëvjeçare sipas disa të dhënave 2.708, e sipas disave 3.212 nxënës shqiptarë, gjithsej 25.573 të tillë. Sipas disa të dhënave tjera, mësimin katërvjeçar e ndiqnin 29.944 nxënës, kurse atë tetëvjeçar 2.708 nxënës.²⁷² Në këtë vit, në klasë të parë ishin regjistruar 7.274 nxënës. E njëjta gjeneratë në klasë të dytë numëronte 5.900 nxënës, ndërsa në klasë të tretë 5.637 nxënës. Pra, në tre vite shkollore mungonin 1.537 nxënës.

²⁶⁵ *Po aty*, f. 101.

²⁶⁶ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi VI, f. 165.

²⁶⁷ Славко Милосавлевски, Мирче Томовски, *vep. cit.*, f. 184, 185; Zeqirja Idrizi, *vep. cit.*, f. 116; Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, f. 485, 486, 491; I njëjti, *Problemi shqiptar...*, vëllimi II, f. 92.

²⁶⁸ Qerim Lita, *NAÇERTANIA...*, f. 121.

²⁶⁹ Zeqirja Idrizi, *vep. cit.*, f. 116; Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, fq. 485, 491; I njëjti, *Problemi shqiptar...*, vëllimi II, f. 92.

²⁷⁰ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, f. 482.

²⁷¹ Славко Милосавлевски, Мирче Томовски, *vep. cit.*, f. 347; Marijana Stamova, *vep. cit.*, f. 76.

²⁷² Zeqirja Idrizi, *vep. cit.*, f. 116; Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, f. 481, 485, 486, 491; I njëjti, *Problemi shqiptar...*, vëllimi II, f. 92.

Nëse nga ky numër hiqeshin 20% e nxënësve që e kanë përsëritur klasën, atëherë ngelshin 1.229 nxënës të cilët e kanë ndërprerë shkollimin. Në të njëjtin vit, tetëvjeçaren e kanë kryer 191 nxënës, kurse në vitin 1955-1956 206 nxënës. Në procesin arsimor nuk u përfshinë 707 nxënës, prej tyre 306 djem dhe 401 vajza.²⁷³ Shkollimin e mesëm, në vitin shkollor 1954-1955 e ndiqnin 459 nxënës dhe 174 nxënës ndiqnin një shkollë normale, të ndarë në 2 gjimnaze të plota, në përbërje të gjimnazeve maqedonase. Në gjimnazin e Tetovës kishte 13 paralele me 348 nxënës. Nga fillimi i veprimtarisë së shkollës e deri në vitin shkollor 1954-1955, nëpër paralelet e saj kishin kaluar 2.432 nxënës.

Deri në vitin 1954-1955 nga 289 nxënës të regjistruar në vitin e IV, gjysmë maturën e kanë kaluar 240 të tillë, prej të cilëve 215 djem dhe 25 vajza. Prej tyre në gjimnaz kanë vazhduar 144 nxënës, 130 djem dhe 14 vajza, në shkollat profesionale kanë vijuar 50 nxënës, 45 djem dhe 5 vajza, kurse 44 nxënës nuk e kanë vazhduar aspak mësimin, prej tyre 38 djem dhe 6 vajza.²⁷⁴ Po ashtu, në vitin shkollor 1954-1955, në Normalen e Shkupit, në vitin e parë janë regjistruar 64 nxënës, 55 kanë mbaruar, me dy paralele, në vitin e dytë 53 janë regjistruar, 53 kanë mbaruar, me dy paralele, në vitin e tretë 36 janë regjistruar, 35 kanë mbaruar, me dy paralele dhe në vitin e katërt 31 janë regjistruar dhe 30 kanë mbaruar, me dy paralele. Prej tyre, 138 ishin bursistë.²⁷⁵

Matura e parë është mbajtur në vitin 1950-1951. Nga Gjimnazi i Tetovës në këtë vit ka pasur 15 kandidatë, 1 prej tyre ishte femër, në vitin 1951-1952, kanë qenë 14 kandidatë, përsëri vetëm 1 vajzë; në vitin 1952-1953 ka pasur 11 kandidatë, 9 djem dhe 2 vajza, në vitin 1953-1954 ka pasur 13 kandidatë, kurse në vitin 1954-1955 ka pasur vetëm 3 kandidatë. Nga këta maturantë të diplomuar, 41 kandidatë e kishin vazhduar shkollimin, kurse 15 nuk e kishin vazhduar. Prej atyre që kanë vazhduar shkollimin 14 ishin regjistruar në Fakultetin Filozofik, 2 në Drejtësi, 2 në Ekonomi, 15 në Mjekësi, 2 në Veterinari, 4 në Teknikë dhe 2 në Shkollën e Lartë Pedagogjike.²⁷⁶

Në vitin akademik 1954-1955 në Universitetin e Shkupit, nga 5.577 studentë, 83 ishin shqiptarë. Prej tyre 52 vetë ishin në Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe 31 nëpër fakultete. Në Fakultetin e Mjekësisë ishin 25 studentë, 2 ishin në Fakultetin e Bujqësisë dhe Pylltarisë dhe 4 në Fakultetin e Arkitekturës dhe Ndërtimtarisë.²⁷⁷ Në vitin shkollor 1955-1956 kishte 230 objekte shkollore të arsimit fillor 4 vjeçar dhe 25 objekte të arsimit fillor tetëvjeçar në gjuhën shqipe, gjithsej 255 objekte. Në shkollat fillore katërvjeçare mësimin e ndiqnin 22.512 nxënës, me 391 arsimtarë, kurse në ato 8 vjeçare, 6.392 nxënës, gjithsej 25.297 të tillë. Në këtë vit në procesin arsimor nuk ishin përfshinë 652 nxënës, prej tyre 302 djem dhe 350 vajza.²⁷⁸

Në vitin 1955, në Qarkun e Ohrit, në arsimin fillor tetëvjeçar, 252 nxënës nuk e ndiqnin në rregull mësimin, kurse 440 nuk shkonin fare. Prej tyre 75% ishin shqiptarë dhe turq. Në Qarkun e Tetovës, 480 nxënës, kryesisht shqiptarë, nuk e vijonin mësimin. Në Qarkun e Tetovës, në tetëvjeçare dhe në gjimnaz, atë kohë, mësimin e ndiqnin 1.464 shqiptarë. Në vitin e parë në Gjimnazin e Tetovës, nga 343 nxënës shqiptarë sa duhej të ndiqnin mësimin, vetëm 126 të tillë e ndiqnin mësimin. Në klasat e larta të gjimnazit, kishte vetëm 62 shqiptarë, edhe atë prej tyre 21 përsëritës, domethënë 41 nxënës të rinj. Në shkollat e ulëta profesionale, mësonin vetëm 59 nxënës shqiptarë.²⁷⁹

²⁷³ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, f. 486, 495.

²⁷⁴ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi II, f. 92; I njëjti, *Problemi shqiptar...*, vëllimi VI, f. 160-161.

²⁷⁵ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi VI, f. 166, 168.

²⁷⁶ *Po aty*, f. 162.

²⁷⁷ Zeqirja Idrizi, *vep. cit.*, f. 127-128; Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, f. 495.

²⁷⁸ Zeqirja Idrizi, *vep. cit.*, f. 116; Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, f. 486, 491.

²⁷⁹ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, f. 458.

Në klasat e larta të gjimnazit të Kumanovës, vetëm 3 nxënës ishin shqiptarë. Për t'u ndryshuar kjo situatë janë ndarë bursa te nxënësit shqiptarë. Në tetëvjeçare dhe në gjimnaz, në vitin shkollor 1953-1954, 7 nxënës shqiptarë kanë marrë bursa, në vitin 1954-1955, 11 nxënës dhe 1955-1956, 7 nxënës. Për shkollën normale janë dhënë: në vitin 1953-1954, 7 bursa për nxënës shqiptarë, në vitin 1954-1955 për 16 nxënës dhe 1955-1956 për 24 nxënës. Në shkollat e mesme profesionale, nga 69 bursistë, vetëm 8 ishin shqiptarë, prej të cilëve, 5 në shkolla të mesme mjekësore, 1 në shkollë të mesme teknike, 1 në shkollë të edukatës fizike dhe 1 në Akademinë e Lartë Pedagogjike. Nëpër fakultete 4 studentë shqiptarë merrnin bursa.²⁸⁰

Pas vitit 1955, arsimi fillor u bë i detyrueshëm. Për këtë u rrit numri i ndërtesave shkollore, në 255, ku 230 ishin të shkollave katërvjeçare dhe 25 të shkollave tetëvjeçare. Në këtë kohë u rihap edhe shkolla normale në Tetovë me katër paralele me 103 nxënës, prej të cilëve 7 ishin vajza.²⁸¹ Në vitin 1955 në Universitetin e Shkupit ishin regjistruar 18 studentë shqiptarë, në vitin 1956, 9 studentë dhe në vitin 1957, 23 studentë.²⁸² Nga 137 persona që shkolloheshin për ekonomi, në fakultet apo shkolla të mesme, nga qarku i Tetovës, vetëm 12 ishin shqiptarë. Në administratë në një nëpunës shqiptar vinin 28 maqedonas. Në një nëpunës shqiptar pa përgatitje shkollore vinin 10 nëpunës të tillë maqedonas.²⁸³

Në vitin shkollor 1956-1957 kishte 176 objekte shkollore të arsimit fillor 4 vjeçar dhe 23 objekte të arsimit fillor 8 vjeçar në gjuhën shqipe, gjithsej 199 objekte. Në shkollat fillore 4 vjeçare mësimin e ndiqnin 24.746 nxënës, kurse në ato 8 vjeçare 6.994 nxënës shqiptarë, gjithsej 31.740 të tillë. Në procesin arsimor nuk u përfshinë 412 nxënës, prej tyre 253 djem dhe 259 vajza.²⁸⁴ Në vitin 1957 në qarkun e Ohrit kishte 50 shkolla fillore në gjuhën shqipe edhe atë 8 ishin tetëvjeçare të plota, 1 shkollë e përzier në gjuhën shqipe, maqedonase dhe turke, ndërsa 41 shkolla ishin katërvjeçare, duke i shtuar edhe 3 paralele shqipe në shkollat katërvjeçare maqedonase. Në qarkun e Shkupit kishte 55 shkolla katërvjeçare në gjuhën shqipe dhe 3 shkolla tetëvjeçare. Në qarkun e Tetovës kishte 82 shkolla katërvjeçare, 65 të pastra shqiptare dhe 17 të përziera.

Përveç tyre ekzistonin edhe 3 shkolla tetëvjeçare me mësim në gjuhën shqipe dhe 3 të tilla të përziera. Krahas shkollimit fillor kishte edhe 2 gjimnaze me 19 paralele dhe 1 shkollë normale me 8 paralele dhe 226 nxënës, nga ku gjimnazet funksiononin në kuadër të gjimnazeve maqedonase.²⁸⁵ Në rrethet e Tetovës, Kumanovës dhe Ohrit vetëm gjatë vitit shkollor 1956-1957 ishin larguar nga procesi arsimor 886 nxënës.²⁸⁶ Në vitin shkollor 1957-1958 kishte 172 shkolla fillore në gjuhën shqipe dhe 18 tetëvjeçare, kurse 42 shkolla fillore dhe 17 tetëvjeçare të përziera. Ose sipas paraleleve: 506 në shkolla fillore me 16.641 nxënës dhe 337 në tetëvjeçare me 11.163 nxënës. Gjithsej 229 shkolla me 843 paralele dhe 27.804 nxënës.

Në të njëjtin vit, në RP të Maqedonisë kishte 584 mësues shqiptarë. Prej tyre 170 udhëhiqnin nga një klasë, 180 nga dy klasë, 3 mësues nga tri klasë dhe 121 mësues nga katër klasë. Po ashtu, në gjimnazin e Tetovës, funksiononin 4 paralele me 57 nxënës. Shkolla Normale e Shkupit kishte 10 paralele me 319 nxënës. Në anën tjetër në arsimin e lartë, në vitin akademik 1957-1958 ishin regjistruar 312 studentë shqiptarë, edhe atë në Fakultetin Filozofik 87, në atë Teknik 12, Mjekësi 33, Drejtësi 29, Ekonomi 29, Bujqësi e Pylltari 13 dhe Akademinë Pedagogjike 109. Ndërsa kishin diplomuar 3 në Filozofik, 1 në Mjekësi, 2 në Drejtësi dhe 17 në Akademinë Pedagogjike.²⁸⁷

²⁸⁰ *Po aty*, f. 458-459.

²⁸¹ Zeqirja Idrizi, *vep. cit.*, f. 116.

²⁸² *Po aty*, f. 129.

²⁸³ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, f. 455.

²⁸⁴ Zeqirja Idrizi, *vep. cit.*, f. 116; Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, f. 486.

²⁸⁵ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, f. 481-482.

²⁸⁶ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi VI, f. 182, 184.

²⁸⁷ Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi II, f. 330-331; Zeqirja Idrizi, *vep. cit.*, f. 116; Qerim Lita, *Problemi shqiptar...*, vëllimi I, f. 490, 505-506.

Përfundimi

Nga të dhënat që kemi vijmë në përfundim që arsimi shqip në Republikën Popullore të Maqedonisë në vitet e '50-ta ishte në gjendje të pakënaqshme. Kuptojmë që më shumë rëndësi qeveria e atëhershme jugosllave i kishte kushtuar hapjes së shkollave në gjuhën turke pavarësisht numrit më të vogël të turqve në raport me shqiptarët. Vijmë në përfundim që numri i analfabetëve të shqiptarët ishte i lartë e sidomos të gratë.

Emancipimi ishte i shkallës së ulët dhe kjo edhe për faktin që momentet e ngritjes së vetëdijes kombëtare të shqiptarët dhe ngritjes së vetëdijes në përgjithësi tek popullata shqiptare shteti Jugosllav do t'i cilësojë si momente kur vepronte elementi shqiptaromadhi dhe do të ndërmerre masa kundër të njëjtës. Përmes analizës së të dhënave kuptojmë që intelegjenca shqiptare do t'i bëjë rezistencë hapjes së shkollave turke dhe se do të punojë për emancipimin e popullatës dhe si rezultat numri i nxënësve shqiptarë që do të ndjekin shkollën do të shënojë rritje. Madje do të ketë edhe të rinj që do të regjistrojnë studimet në universitet dhe të diplomuar shqiptarë në fusha të ndryshme.

Shkurtesat:

RP – Republika Popullore

KQ – Komiteti Qendror

PKM – Partia Komuniste e Maqedonisë

PKS – Partia Komuniste e Serbisë

LKJ- Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë

Referencat

- [1]. Lita, Qerim, *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974-Përmbledhje dokumentesh - Qëndresa antikomuniste*, vëllimi I, Shkup.
- [2]. Lita, Qerim, *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974-Përmbledhje dokumentesh - Procesi i shpërnguljes*, vëllimi II, Shkup, 2018.
- [3]. Lita, Qerim, *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974-Përmbledhje dokumentesh - Arsimi, Kultura, Religjioni*, vëllimi VI, Shkup.
- [4]. Stamova, Marijana, *Faktori shqiptar në Republikën Socialiste të Maqedonisë (1945-1981)*, Tiranë, 2014.
- [5]. Lita, Qerim, *NAÇERTANIA - K. Červenkovski dhe identiteti shqiptar në Maqedoni (1945-1954)*, Shkup, 2007.
- [6]. Lita, Qerim, *Territoret lindore shqiptare 1912-1960 (Punime studimore)*, Shkup, 2016.
- [7]. Милосавлевски, Славко, Томовски, Мирче, *Албанците во Република Македонија 1945-1995 (Легислатива, Политичка документација, Статистика)*, Скопје.
- [8]. Idrizi, Zeqirja, *Pozita e shqiptarëve në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore*, Tetovë, 2003.